



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më ____ . ____ . 2024

VENDIM

Nr. 691, datë 15.11.2023

PËR

**SKUALIFIKIMIN DHE NDËRPRERJEN E MARRËDHËNIES SË PUNËS SË
KANCELARES NË DETYRË NË GJYKATËN
E SHKALLËS SË PARË TË JURIDIKSIONIT TË PËRGJITHSHËM SHKODËR,
ZNJ. {...}**

Këshilli i Lartë Gjyqësor, mbështetur në nenin 83, të ligjit nr. 98/2016, “Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, në nenin 61, pika 1, 86 shkronja “ë” dhe 97 pika 1, shkronja “a” të ligjit nr. 115/2016, “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar, si dhe në Vendimin e Këshillit të Lartë Gjyqësor nr. 424, datë 12.10.2020, “Për procedurën e verifikimit të kushteve dhe kriterëve ligjore të rekrutimit të kandidatit për kancelar, për këshilltar ose për ndihmës ligjor”, në mbledhjen e datës 15.11.2023, pasi shqyrtoi materialet e çështjes dhe relacionin e përgatitur nga relatorja e procedurës së verifikimit znj.Fatmira Luli, mbi gjendjen e faktit dhe ligjin e zbatueshëm në lidhje me verifikimin e kushteve dhe kriterëve ligjore të pozicionit, pasurisë dhe figurës, të kancelares në detyrë, {...},

VËREN:

I. PROCEDURA E VERIFIKIMIT

1. Znj. {...} ka qenë kancelare në detyrë pranë ish - Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Pukë dhe aktualisht është kancelare në detyrë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Shkodër¹. Me vendimin nr. 496, datë 21.10.2020, “Për fillimin e procedurës së verifikimit të kancelarëve në detyrë”, bazuar në nenet 53, 55 dhe 83, të ligjit nr.98/2016, “Për

¹ Këshilli i Lartë Gjyqësor me vendimin nr. 136, datë 28.03.2023 ka vendosur që Gjykata e Rrethit Gjyqësor Shkodër të emërtohet Gjykata e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Shkodër. Ndërsa me vendimin nr. 192, datë 26.04.2023, KLGJ ka vendosur transferimin në mënyrë të përhershme të znj. {...} kancelar në detyrë, në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Shkodër.

organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë” dhe vendimin nr. 424, datë 12.10.2020, “Për procedurën e verifikimit të kushteve dhe kriterëve ligjore të rekrutimit të kandidatit për kancelar, për këshilltar ose për ndihmës ligjor”, Këshilli i Lartë Gjyqësor ka filluar procedurën e verifikimit për plotësimin e kushteve dhe kriterëve ligjore të pozicionit, verifikimin e pasurisë dhe figurës për znj. {...} duke u caktuar me short relatore znj. Fatmira Luli.

2. Në datën 26.10.2020, në respektim të detyrimeve të përcaktuara në Seksionin A, Kreu XI, të Vendimit 424/2020, kancelarja në detyrë znj. {...}, në rrugë elektronike, u njoftua:

- për fillimin e procedurës së verifikimit të kushteve dhe kriterëve ligjore të pozicionit, të pasurisë dhe figurës, për kancelarët në detyrë;

- për caktimin e relatores së kësaj procedure verifikimi;

- për të drejtën që kishte për të kërkuar përjashtimin e relatores së caktuar dhe/ose të çdo anëtari tjetër të Këshillit, brenda 3 (tre) ditëve nga marrja e këtij njoftimi.

Po ashtu, kancelari në detyrë u njoftua edhe për detyrimin për plotësimin e formularit deklarues për adresën postare, adresën elektronike dhe kontaktit telefonik, për qëllimet e procedurës së verifikimit ndaj saj, formular ky që i është bashkëngjitur njoftimit.

3. Brenda afatit treditor, kancelarja në detyrë znj. {...}, depozitoi rregullisht të plotësuar formularin deklarues për adresën postare, adresën elektronike dhe kontaktit telefonik, për qëllimet e procedurës së verifikimit ndaj saj. Nga ana tjetër, në këtë afat, kancelarja në detyrë nuk parashtroi ndonjë pretendim në lidhje me relatoren e caktuar për procedurën e verifikimit ndaj saj apo për ndonjë anëtar tjetër të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

4. Në datën 02.11.2020, bazuar në pikën 11, Seksioni B, Kreu IV, të Vendimit 424/2020, kancelares në detyrë znj. {...}, në rrugë elektronike, iu dërguan formularët dhe autorizimet përkatëse (të përcaktuara në pikën 15, Seksioni C, Kreu IV, të Vendimit 424/2020) që duhet të plotësoheshin dhe dorëzoheshin prej saj në kuadër të procedurës së verifikimit të kushteve dhe kriterëve ligjore të pranimit në shërbimin civil gjyqësor.

5. Në datë 06.11.2020, u njoftua Inspektorati i Lartë të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave (më poshtë referuar si ILDKPKI), për listën e kancelarëve në detyrë, për të cilët do të kryhej deklarimi i pasurisë².

6. Brenda afatit treditor, kancelarja në detyrë znj. {...}, depozitoi në zyrën përkatëse të Këshillit formularët dhe autorizimet përkatëse, ndërsa brenda afatit 2 javor (sipas pikës 68, Seksioni B, Kreu VI, të Vendimit 424/2020), ajo dorëzoi rregullisht edhe formularin “Deklaratë e pasurisë dhe interesave privatë të kandidatit për pozicione të ndryshme në institucionet e sistemit të drejtësisë” pranë Inspektoratit të Lartë të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave (më poshtë referuar si ILDKPKI).

² Shih shkresën nr. 5678 prot., datë 05.11.2020, drejtuar Inspektoratit të Lartë të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave.

7. Gjatë procedurës së verifikimit, nga data 30.10.2020, bazuar në pikën 15, Seksioni C, Kreu VI, të Vendimit 424/2020, përmes shkresave të veçanta, u kërkua informacion dhe raportim nga institucionet kompetente për verifikimin e kushteve dhe kriterëve ligjore të pozicionit, pasurisë dhe të figurës, përcaktuar në nenet 55, 56 dhe 83, të ligjit nr. 98/2016, për kancelarët në detyrë, ndër ta edhe për znj. {...}.

8. Institucionet kompetente për verifikimin e pasurisë dhe të figurës si dhe institucionet e tjera të cilat administrojnë informacionin e nevojshëm në kuadër të verifikimit të kushteve dhe kriterëve ligjore të pozicionit, kanë përcjellë për Këshillin e Lartë Gjyqësor informacionet dhe raportimet e tyre në kohë të ndryshme (siç do të përshkruhet më poshtë).

II. REZULTATET E VERIFIKIMIT

A. Për kushtet/kriteret e përgjithshme ligjore të pozicionit, sipas nenit 55, pika 1, të ligjit nr. 98/2016

9. Për kancelaren në detyrë {...} u verifikuan kriteret e përgjithshme për pranimin në shërbimin civil gjyqësor, përcaktuar në nenin 55, pika 1, të ligjit nr. 98/2016, kushte të cilat përcaktohen si kriteret e përgjithshme të pranimit në shërbimin civil edhe në nenin 21, të ligjit nr.152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, si më poshtë:

a) *Të jetë shtetas shqiptar* – Për këtë kriter, në dokumentin “Kartë Identiteti”, lëshuar nga Ministria e Brendshme më datë 06.06.2009, pasqyrohet edhe përbërësi i gjendjes civile “shtetësia”, që në këtë rast pasqyrohet “shqiptare”. Nuk rezulton ndonjë e dhënë për lënien ose heqjen e shtetësisë shqiptare për subjektin pas këtij momenti;

b) *Të ketë zotësi të plotë për të vepruar* – Për këtë kriter, nuk u gjet ndonjë e dhënë për heqjen apo kufizimin e saj me vendim gjyqësor të formës së prerë;

c) *Të zotërojë gjuhën shqipe, të shkruar dhe të folur* – Zotërimi i gjuhës shqipe të folur dhe të shkruar prezumohet për çdo shtetas shqiptar që ka përfunduar arsimin e detyrueshëm;

d) *Të jetë në kushte shëndetësore që e lejojnë të kryejë detyrën përkatëse* – Subjekti rezulton se është në kushte shëndetësore të cilat e lejojnë të kryejë detyrën pasi, sipas raportit mjeko-ligjor me nr. Rregjistri 229, datë 15.03.2019, lëshuar nga Poliklinika Pukë, ka rezultuar "I aftë për punë" dhe nuk rezultojnë të dhëna të mëvonshme për cenimin e kësaj aftësie;

e) *Të mos jetë i dënuar me vendim të formës së prerë për kryerjen e një krimi apo për kryerjen e një kundërvajtjeje penale me dashje.* - Sipas dëshmisë së penalitetit me nr. 11 prot., datë 27.03.2019, lëshuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve dhe informacionit të përpunuar nga Struktura e Posaçme pranë KLGJ³, referuar dokumentacionit të përditësuar, dërguar nga Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve, rezulton se znj. {...} nuk është e dënuar me vendim penal të formës së prerë. Gjithashtu, nga të dhënat e dosjes personale dhe tërësia e dokumentacionit të administruar

³ Shih shkresën me nr. 5347/130 prot., datë 20.04.2021, të Strukturës së Posaçme për Regjistrimin, Administrimin dhe Përpunimin e Formularëve të Vetëdeklarimit pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor.

gjatë procedurës së verifikimit, nuk rezultojnë të dhëna të mëvonshme që të cenojnë përmbushjen këtij kriteri;

f) *Ndaj tij të mos jetë marrë masa disiplinore e largimit nga shërbimi civil, që nuk është shuar sipas këtij ligji* – Për këtë kriter, gjatë verifikimit, sipas vetëdeklarimit të bërë nga kancelarja në detyrë znj. {...} në jetëshkrimin (CV) e depozituar në dosjen e personelit, si dhe shënimet në librezën e punës, u konstatua si më poshtë:

(i) për periudhën 01.11.2008 deri në datë 01.12.2013, ajo ka qenë e punësuar si juriste, pranë Bashkisë Pukë. Nga informacioni i marrë me shkresën nr. 84/1 prot., datë 22.01.2021, ndaj saj nuk është marrë asnjë masë disiplinore.

(ii) për periudhën nga data 12.12.2013 deri në datën 30.04.2023 znj. {...} ka ushtruar detyrën e kancelares në Gjykatën së rrethit Gjyqësor Pukë dhe prej datës 01.05.2023 e në vijim, pas miratimit të hartës së re gjyqësore, ka ushtruar detyrën e kancelares në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Shkodër⁴. Nga shkresa nr. V- 44/1 prot., datë 28.03.2019, e Ministrisë së Drejtësisë, e depozituar në dosjen e personelit, rezulton se kancelarja në detyrë nuk ka patur masa disiplinore për vitet 2014-2019. Nga viti 2019 dhe në vijim, në Këshillin e Lartë Gjyqësor nuk rezultojnë të dhëna e as janë zhvilluar procedura për marrjen e masave disiplinore ndaj tij.

B. Për kriteret e veçanta sipas nenit 56, pika 1, të ligjit nr. 98/2016

10. Kriteret e parashikuara në nenin 56, pika 1, të ligjit nr. 98/2016, *“Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë”* përcaktohen si kriteret e veçanta për pranimin e nëpunësve civilë gjyqësorë. Për kancelaren në detyrë {...} u verifikuan kriteret e veçanta, si më poshtë:

a) *Të plotësojë kërkesat e posaçme për nivelin e arsimit* – Në lidhje me këtë kriter, në nenin 56, pika 1, shkronja “a” të ligjit nr.98/2016 parashikohet se kandidatët për kancelar duhet të jenë diplomuar në drejtësi ose ekonomi në nivelin *“Master shkencor”* ose të barasvlershëm me të, sipas përcaktimeve të legjisllacionit të arsimit të lartë. Nga verifikimi i dokumentacionit të ndodhur në dosjen personale të kancelares në detyrë, znj. {...} ka depozituar dokumentet si më poshtë:

- “Diplomë të Nivelit të Parë në Drejtësi”, me nr. 458, datë 03.08.2009, lëshuar nga Universiteti jo publik “Kristal”;
- Vërtetim notash datë 31.10.2010, lëshuar nga Universiteti jo publik “Kristal”; - “Diplomë të Nivelit të Dytë në Drejtësi”, me nr. 264, datë 28.09.2011, lëshuar nga Universiteti jo publik “Kristal”;
- Vërtetim notash datë 28.09.2011, lëshuar nga Universiteti jo publik “Kristal”;

⁴ Me vendimin nr. 192, datë 26.04.2023, KLGJ ka vendosur transferimin në mënyrë të përhershme të znj. {...} kancelar në detyrë në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Shkodër.

Për sa më sipër, rezulton se znj. {...} ka përfunduar edhe ciklin e dytë të studimeve universitare për drejtësi, sipas përcaktimeve të legjislacionit të arsimit të lartë, referuar pikës 3⁵ të nenit 124, ligjit nr. 80/2015, “Për arsimin e lartë”, pra ka nivelin e përshtatshëm të arsimimit në raport me pozicionin e punës.

b) Të ketë përvojë profesionale mbi tetë vjet, nga të cilat së paku tre vjet në pozicione administruese ose pesë vjet në sistemin gjyqësor. Nga verifikimi i dokumentacionit të administruar në dosjen personale, lidhur me marrëdhënien e punësimit, sipas shënimeve në librezën e punës dhe dokumentacionit të administruar në dosjen personale të kancelares në detyrë, rezulton se znj. {...} ka përvojë profesionale mbi tetë vjet, pasi nga periudha 01.11.2008 – 01.12.2013, ajo ka ushtruar detyrën e juristes pranë Bashkisë Pukë. Prej datës 12.12.2013 ajo ka filluar punë në pozicionin e Kancelares së gjykatës e rrethit gjyqësor Pukë dhe prej datës 01.05.2023 këtë detyrë ajo e ushtron pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Shkodër, funksion të cilin e ka ushtruar pa ndërprerje deri aktualisht. Sa më sipër, rezulton se znj. {...} plotëson kriterin e përvojës profesionale të përgjithshme mbi tetë vjet, pasi rezulton që ka punuar si juriste dhe kancelarë e gjykatës për më shumë se 16 vjet, si dhe kriterin e përvojës profesionale specifike prej 5 vitesh në sistemin gjyqësor, pasi rezulton se ushtron funksionin e kancelares prej datës 12.12.2013 dhe në vijim, prej rreth 7 vjet në momentin e fillimit të procedurës së verifikimit.

Kjo përvojë profesionale konfirmohet edhe nga përgjigja e përcjellë nga Instituti i Sigurimeve Shoqërore, që provon edhe derdhjen e kontributeve të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore, sikurse më lart është cituar.

C. Për kriterin e pasurisë

11. Për kancelaren në detyrë {...} u verifikua kriteri i pasurisë, përcaktuar në pikën 1, të nenit 83, të ligjit nr. 98/2016. Konkretisht, për verifikimin e kriterit të pasurisë për kancelaren në detyrë, u kërkua raportim nga ILDKPKI-ja, e cila ka dërguar në Këshillin e Lartë Gjyqësor raportin “*Akti i përfundimit të kontrollit të plotë të Deklaratës së Pasurisë dhe të Interesave Privatë të kancelarit në detyrë, {...}, në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Pukë*”, nr. 325/24 prot., datë 24.03.2021⁶.

11.1 Sipas Raportit të ILDKPKI-së, kancelarja në detyrë {...} dhe personat e lidhur z. {...}{...} (bashkëshorti), znj. {...} ({...}) (e bija), {...}{...} (i biri) dhe {...}{...} (e bija) kanë plotësuar dhe depozituar në afatin e caktuar nga Këshilli i Lartë Gjyqësor formularin e deklaratës së pasurisë, si dhe autorizimet e kërkuara për verifikimin e pasurisë dhe interesave private.

⁵Në nenin 124, pika 3 të ligjit nr. 80/2015, “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë”, parashikohet se :”3. *Diplomat për programet e integruara të nivelit të dytë (DIND), të lëshuara para hyrjes në fuqi të këtij ligji, janë ekuivalente me diplomën universitare “Master i shkencave”.*

⁶ Depozituar në Këshill, me nr. 5678/38 prot., datë 24.03.2021.

11.2 Po ashtu, sipas Raportit të ILDKPKI-së, datë 24.03.2021, nga kjo e fundit janë kryer kontrollat e plota për pasuritë, asetet dhe interesat e deklaruara nga kancelaren në detyrë {...} dhe personat e lidhur, duke konkluduar se:

- a) deklarimi nuk është i saktë në përputhje me ligjin;
- b) dokumentacioni jo i plotë justifikues ligjor për burimin e krijimit të pasurisë;
- c) nuk ka fshehje të pasurisë;
- d) nuk ka kryer deklarim të rremë;
- e) nuk gjendet në situatën e konfliktit të interesave.

11.2.1. Konkluzionet si më sipër, bazohen në rezultatet e kontrollit të kryer nga ILDKPKI, në lidhje me sa vijon:

- Mungesë dokumentacioni justifikues ligjor, lidhur me faktin nëse shoqëria “Eni 2000” shpk, ka shpërndarë ose jo dividend, i cili deklarohet burim pjesor për asetet e deklaruara. Kandidati ka deklaruar të ardhura nga biznesi privat, subjekti “Eni 2000” shpk, Pukë, nga data e krijimit, shtator 2000 deri në tetor 2008, ku ka qenë përfaqësues ligjor i subjektit, në shumën rreth 4.100.000 lekë, por sipas bilanceve vjetore të dorëzuara për të njëjtën periudhë, fitimi neto i shoqërisë “Eni 2000” shpk, rezulton në vlerën totale prej rreth 8.200.000 lekë.
- Mungesë dokumentacioni justifikues ligjor për të ardhurat e bashkëshortit para vitit 1998, të cilat kanë shërbyer si burim për blerjen e apartamentit në vitin 2001 në Rr. “Rexhep Teni” Pukë.
- Rezulton se nuk është pasqyruar ndërtimi i shtesës anësore në vitin 2009, në Rr. “Rexhep Teni”, pallati nr. 47, Pukë.
- Mungesë dokumentacioni justifikues ligjor, lidhur me automjetin e deklaruar në pronësi të vajzës së kandidatit, {...}, e cila është e martuar dhe banon jashtë Shqipërisë.
- Nga nxjerrjet e llogarive të kandidatit dhe b/shortit të saj në RFZ Bank, ndër vite, rezultojnë transaksione debi/kredi, me/nga llogaritë e subjektit tregtar “Eni 2000” shpk. Mungesë dokumentacioni ligjor me marrëdhënien dypalëshe, si dhe është e paqartë arsyeja e kalimit të vlerave nga llogaria e biznesit në llogaritë personale dhe anasjelltas.
- Mungesë dokumentacioni justifikues për të ardhurat e shtetasit {...} (vëllai i kandidatit) për huamarrjen në shumën 37.000 euro, në vitin 2009, nga ana e b/shortit, që ka shërbyer si burim për huadhënienë shumën 40.000 euro shtetasit {...}. Nuk është e qartë nëse huamarrja në shumën 37.000 euro është kthyer dhe nëse po, mënyrën e kthimit.
- Mungesë dokumentacioni justifikues (kontratë shitje automjeti), për të vërtetuar shitjen e automjetit tip Mercedes E 270, nga ana e djalit {...}{...}, në vitin 2019.

11.3 Bazuar në Vendimin e Këshillit të Lartë Gjyqësor nr. 424, datë 12.10.2020, “Për procedurën e verifikimit të kushteve dhe kriterëve ligjore të rekrutimit të kandidatit për kancelar, për këshilltar ose për ndihmës ligjor” (pika 16, seksioni C, kreu IV dhe pika 73, seksioni B, kreu VI), Këshilli, nëpërmjet komunikimit elektronik më datë 26.03.2021, ftoi kancelaren në detyrë znj. {...} për të paraqitur shpjegime dhe çdo dokumentacion mbështetës lidhur me raportin e kontrollit të Deklaratës së Pasurisë dhe Interesave private të përgatitur nga ILDKPKI.

11.3.1 Më datë 02.04.2021, znj. {...} ka dërguar nëpërmjet postës elektronike kundërshtimet lidhur me raportin e ILDKPKI-së. Këshilli me shkresën nr. 5678/54 prot., datë 14.04.2021 ka dërguar pranë ILDKPKI-së shpjegimet dhe dokumentacionin e dorëzuar nga subjekti, duke kërkuar, në përputhje me parashikimet e pikës 76, seksioni B, kreu VI të vendimit nr. 424/2020, trajtimin dhe përgatitjen e një raporti shtesë lidhur me subjektin.

11.3.2 Në datë 26.04.2021 ILDKPKI ka dërguar raportin shtesë me nr. 2990/37 prot., për kontrollin e plotë për pasuritë, asetet dhe interesat e deklaruara nga subjekti, duke konkluduar se:

- a) *deklarimi nuk është i saktë në përputhje me ligjin;*
- b) *dokumentacioni jo i plotë justifikues ligjor për burimin e krijimit të pasurisë;*
- c) *nuk ka fshehje të pasurisë;*
- d) *nuk ka kryer deklarim të rremë;*
- e) *nuk gjendet në situatën e konfliktit të interesave.*

11.3.3 Konkluzionet si më sipër, bazohen në rezultatet e kontrollit të kryer nga ILDKPKI, në lidhje me sa vijon:

- *Mungesë dokumentacioni justifikues ligjor, lidhur me faktin nëse shoqëria “Eni 2000” shpk, ka shpërndarë ose jo dividend, i cili deklarohet burim pjesor për asetet e deklaruara.*
- *Kandidati ka dhënë shpjegime lidhur me të ardhurat e bashkëshortit para vitit 1998, të cilat kanë shërbyer si burim për blerjen e apartamentit në vitin 2001 në Rr. “Rexhep Teni” Pukë. Nuk ka paraqitur dokumentacion justifikues për të ardhurat nga familja bujqësore.*
- *Mungesë dokumentacioni justifikues për të ardhurat e shtetasit {...} (vëllai i kandidatit) për huamarrjen në shumën 37.000 euro, në vitin 2009, nga ana e b/shortit, që ka shërbyer si burim për huadhënienë shumën 40.000 euro shtetasit {...}. Nuk është e qartë nëse huamarrja në shumën 37.000 euro është kthyer dhe nëse po, mënyrën e kthimit.*

11.3.4 Lidhur me konstatimet e Raportit të parë të ILDKPKI, me nr. 325/24 prot., datë 24.03.2021, kundërshtimet e znj. {...} në mënyrë të përmbledhur janë si më poshtë:

- *“Sqaroj se fitimi i deklaruar për subjektin privat “ENI 2000” për periudhën shtator të vitit 2000 deri me 31.12.2008 është në shumën 8.191.921 lekë dhe dokumentacioni për shpërndarjen e dividendit ndodhet pranë organeve të tatim taksave, ish-Dega e tatim taksave Pukë dhe në Drejtorin Rajonale Tatimeve Shkodër, ku shpërndarja e fitimit është bërë rregullisht sipas përcaktimeve në ligjislacionin në fuqi. Në rast të mosplotësimit të dokumentacionit për shpërndarje të dividendit në kohën e duhur këto organe bëjnë pezullimin e veprimtarisë së subjektit, pra ka qenë e detyrueshme dhe është bërë rregullisht. Për sa i përket deklarimit të fitimit për periudhën shtator 2000 deri 31.12.2008 është deklaruar gabim nga ana ime. Ekonomisti i subjektit z. Ismet Ahmetaj kishte bërë lapsus, gabim njerëzor dhe jo për të fshehur asgjë, ndjesë për gabimin, pra shuma totale e fitimit është 8.191.921 lekë, shumë e cila është trajtuar si e shpjegova më lart, në bazë të legjislacionit. Është bërë shpërndarja e dividendit.*

- Sqarohet se në korrik të vitit 1998 kemi lëvizur vendbanimin nga fshati Iballë, rrethi Pukë dhe jemi vendosur në qytetin e Pukës. Përpara vitit 1998 kemi jetuar në një familje me babain, nënën, vëllain dhe motrat e bashkëshortit, ku në fshat kemi patur tokë ku e dispononte babai i bashkëshortit, kemi mbajtur bagëti, shpend, bletë, ekonomi e vogël prodhuese, ku kanë sjelle fitime, ne kemi përfituar nga shpërndarja e fitimit pasi jemi ndarë nga familja, për të shkuar në qytet dhe bashkëshorti filloi punë në Degën e Thesarit Pukë. Këto të ardhura i kemi përdorur për blerjen e apartamentit në Pukë, rruga “Rexhep Teni”, si e kemi deklaruar.

- Sqarohet se në vitin 2009, me leje të Bashkisë Pukë është bërë shtesë pallatit pesë katësh ku banojmë edhe sot akoma, nuk kemi pronësi mbi këtë shtesë. Kemi dorëzuar të gjithë dokumentacionin e nevojshëm pranë zyrave të Aluiznit Shkodër për ta regjistruar si pronë, por akoma nuk kemi marrë pronësinë e kësaj shtese, për këtë nuk e kemi deklaruar. Ku dhe vlera e shtesës së apartamentit ka qenë 250,000 lekë.

- Po është e vërtetë që bashkëshorti i vajzës, {...} i ka dhuruar bashkëshortes {...} një mjet tip Volksäagen Phaton veturë, për ta regjistruar në Shqipëri me targa shqiptare, për levizje në Shqipëri kur vjen me pushime, pasi {...} nuk ka shtetësi shqiptare. Nuk kemi kopje të aktdhurimit, por mund të jetë në Drejtorinë Rajonale të Transportit Shkodër, ku është dorëzuar sipas tyre për ndryshimin e pronësisë së mjetit, ose kur është bërë zhdoganimi i mjetit.

- 2000 - 2008, bashkë me bashkëshortin {...}{...} jemi paraqitur pranë RFZ Bank Pukë, sipas kërkesës që kishte banka dhe kam autorizuar bashkëshortin që të ketë akses për kryerjen e veprimeve bankare për llogari të subjektit. Për sa i përket paqartësisë së kalimit të vlerave nga llogaria e biznesit në atë private është bërë për arsye që bashkëshorti menaxhonte biznesin dhe për lehtësi veprimi, ku jo çdo gjë në atë kohë u kryente me transaksione nëpërmjet bankës, por me cash në dorë, për blerje materialesh ndërtime, likuidim faturash, karburant e mjete transporti, etj. Kjo ka qenë arsyeja.

- Për sa i përket dokumentacionit justifikues për të ardhurat e vëllait tim, {...}, dua të sqarohet se vëllai jeton dhe punon në shtetin grek që në vitin 1995, ku është subjekt juridik ndërtimi dhe nuk disponoj dokument për të ardhurat e tij, përveç dokumentit që kam dorëzuar në ILDKPKI, i ardhur nga shteti grek, i cili i përket huadhënies prej 37.000 euro, të marrë nga bashkëshorti, të cilat bashkëshorti ja ka dhënë shtetasit {...} me kontratë huaje (akt noterial) të cilat si e kam deklaruar na janë kthyer në dorë nga shtetasi {...}.

- Po mungonte kontrata e shit-blerjes së automjetit tip mercedez E270 nga ana e djalit, të cilën nuk kemi mundur ta gjenim, se ku e kishte lënë djali, pastaj iu drejtuam Zyrës Noteriale nga kishte dalë akt-shitja dhe na është dhënë një kopje, të cilën po jua dërgoj të skanuar”.

11.3.5 Bazuar në raportin shtesë të dërguar nga ILDKPKI-ja, Këshilli, bazuar në Vendimin nr. 424/2020 (pika 16, seksioni C, kreu IV dhe pika 73, seksioni B, kreu VI), nëpërmjet komunikimit elektronik me datë 04.05.2021, ftoi kancelaren në detyrë znj. {...} për të paraqitur shpjegime dhe çdo dokumentacion mbështetës lidhur me raportin shtesë të kontrollit të Deklaratës së Pasurisë dhe Interesave privatë të përgatitur nga ILDKPKI.

11.3.6 Më datë 06.05.2021, lidhur me raportin shtesë të ILDKPKI-së, nëpërmjet komunikimit elektronik znj. {...} ka sqaruar se: “Ju vë në dijeni dhe ju informoj se nuk kam asnjë dokument

shtesë për të dorëzuar, pasi çdo dokument që unë kam disponuar jua kam vënë në dispozicion. Ju bëj me dije se në datë 30.11.2016 më janë djegur 5 (pesë) dhoma shtëpi me gjithçka kam patur brenda dhe kjo vërtetohet nga dokumentat që kam dorëzuar. Ju njoftoj se nuk disponoj më asnjë lloj dokumenti përveç atyre që kam dorëzuar”.

12. Për verifikimin e kriterit të pasurisë për kancelaren në detyrë {...} dhe personave të lidhur z. {...}{...} (bashkëshorti), znj. {...} ({...}) (e bija), {...}{...} (i biri) dhe {...}{...} (e bija), u kërkua informacion nga Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve⁷ dhe Drejtoria e Përgjithshme e Doganave⁸.

12.1 Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve me shkresën nr. 22524/2 prot, datë 04.12.2020, protokolluar në Këshill me nr. 5347/11 prot, datë 07.12.2020, ka përcjellë informacionin e kërkuar nga KLGJ, për kancelaren në detyrë dhe personat e lidhur. Sipas informacionit, shtetasi {...}{...} (i biri i kancelares në detyrë) rezulton subjekt tatimpagues si person fizik me NUIS L89306301K, në juridiksionin DRT Shkodër dhe aktualisht rezulton me status tatimpagues “çregjistruar” që më datë 30.07.2019

12.2 Drejtoria e Përgjithshme e Doganave me shkresën nr. 21636/1 prot, datë 14.12.2020, protokolluar në Këshill me nr. 5847/13 prot, datë 15.12.2020, ka përcjellë informacionin e kërkuar nga KLGJ, për kancelaren në detyrë dhe personat e lidhur. Në këtë informacion nuk jepet ndonjë e dhënë me karakter pasuror për kancelaren në detyrë, kurse për personin e lidhur referohet se znj. {...} ({...}) (e bija) ka zhdoganuar në Doganën Hani i Hotit një automjet me Im. 4, nr. R 31220, datë 23.12.2019.

13. Të dhënat e dërguara përmes informacioneve respektive nga Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve, Instituti i Sigurimeve Shoqërore dhe Drejtoria e Përgjithshme e Doganave, u ballafaquan me të dhënat sipas Raporteve të ILDKPKI-së. Po ashtu, referuar të dhënave të përshkruara në Raportin e ILDKPKI-së, të nxjerra nga dokumentacioni i paraqitur nga vetë kancelarja në detyrë, si dhe ai i administruar nga korrespondenca me subjekte shtetërore dhe privatë, dokumentacion që evidentohet hollësisht në Raport, sikundër dhe analizës financiare të bërë nga ky organ publik, përgjegjës për kontrollin e deklarimit të pasurive dhe konfliktit të interesave sipas ligjit nr. 9049, datë 10.04.2003, “Për deklarin dhe kontrollin e pasurive, detyrimeve financiare të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publik”, i ndryshuar, nuk u konstatua mangësi në raportim. Sa i përket të ardhurave të subjektit të cilat rezultojnë se e kanë burimin nga paga e saj si e punësuar pranë Gjykatës së Rrethit Pukë, rezulton se ato janë marrë në analizë në mënyrë të hollësishme nga ILDKPKI dhe nuk janë konstatuar problematika lidhur me deklarinim ose burimin e tyre.

⁷ Shkresa nr. 5347/4 prot., datë 19.11.2020 e Këshillit të Lartë Gjyqësor.

⁸ Shkresa nr. 5347/4 prot., datë 19.11.2020 e Këshillit të Lartë Gjyqësor.

14. Mbi kërkesë të Këshillit të Lartë Gjyqësor⁹, ILDKPKI, me shkresën nr. 2940/1 prot., datë 17.06.2021, ka dërguar në format elektronik (CD) dosjen e kontrollit të plotë për kancelaren në detyrë {...}. Duke krahasuar të dhënat e përshkruara në Raportin e ILDKPKI-së, (sipas CD) si dhe pretendimeve me shkrim të znj. {...}, të shoqëruara me dokumentacion nga vetë ajo rezulton se nuk konstatohet mangësi në deklarimin e kryer nga kancelarja në detyrë dhe deklarimi është i saktë në përputhje me ligjin.

15. Komisioni i Planifikimit Strategjik, Administrimit dhe Buxhetit, i mbledhur në datë 18.11.2021, vendosi që për nevoja të procedurës së verifikimit, për kancelaren në detyrë {...} dhe për personat e lidhur me të, t'i kërkojë informacion ILDKPKI-së¹⁰, nëse nga ana e këtij institucioni është realizuar ndonjëherë kontroll i deklaratave periodike vjetore të saj, nga momenti kur është bërë subjekt deklarimi dhe nëse janë marrë masa administrative në kuadër të procedurës së kontrollit. Me shkresën nr. 2990/65 prot., datë 29.11.2021, ILDKPKI ka informuar se për kancelarien në detyrë {...} nuk ka marrë masa administrative.

16. Komisioni i Planifikimit Strategjik, Administrimit dhe Buxhetit, i mbledhur në datë 06.12.2021, mori në analizë të gjithë dokumentacionin e depozituar nga kancelarja në detyrë, duke e ballafaquar me të dhënat sipas të dy raporteve të ILDKPKI-së, duke arritur në konkluzionet si më poshtë, konkretisht:

16.1 Konkluzioni i arritur nga ILDKPKI mbi mungesën e dokumentacionit justifikues ligjor, lidhur me faktin nëse shoqëria “Eni 2000” shpk, ka shpërndarë ose jo dividend, i cili deklarohet burim pjesor për asetet e deklaruara, u krahasua me dokumentacionin e depozituar nga kancelarja në detyrë si dhe u morën në konsideratë edhe shpjegimet e saj. Nga krahasimi rezultoi se fitimi i deklaruar për subjektin privat “ENI 2000”, për periudhën shtator të vitit 2000 deri me 31.12.2008, është në shumën 8.191.921 lekë dhe dokumentacioni për shpërndarjen e dividendit ndodhet pranë organeve të tatim taksave, ish-Dega e tatim taksave Pukë dhe në Drejtorin Rajonale Tatimeve Shkodër. Shpërndarja e fitimit është bërë rregullisht sipas përcaktimeve në ligjislacionin në fuqi.

16.2 Konkluzioni i arritur nga ILDKPKI se znj. {...} nuk ka paraqitur dokumentacion justifikues për të ardhurat nga familja bujqësore, por vetëm ka dhënë shpjegime lidhur me të ardhurat e bashkëshortit para vitit 1998, të cilat kanë shërbyer si burim për blerjen e apartamentit në vitin 2001 në Rr. “Rexhep Teni” Pukë. Nga krahasimi me dokumentacionin e depozituar nga kancelarja në detyrë si dhe duke u marrë në konsideratë edhe shpjegimet e saj, u vlerësua se të ardhurat e familjes përpara vitit 1998 janë përdorur për blerjen e apartamentit në Pukë, rruga “Rexhep Teni”.

16.3 ILDKPKI ka arritur në konkluzionin se ka mungesë dokumentacioni justifikues për të ardhurat e shtetasit {...} (vëllai i znj. {...}) për huamarrjen në shumën 37.000 euro, në vitin 2009,

⁹ Shkresa nr. 5678/86 prot., datë 07.06.2021 e Këshillit të Lartë Gjyqësor.

¹⁰ Shkresa nr. 2678/115 prot., datë 19.11.2021 e Këshillit të Lartë Gjyqësor.

nga ana e b/shortit, që ka shërbyer si burim për huadhënie në shumën 40.000 euro shtetasit {...} dhe se nuk është e qartë nëse huamarrja në shumën 37.000 euro është kthyer apo jo, dhe nëse po cila ka qenë mënyra e kthimit. Për këtë u krahasua dokumentacioni i depozituar nga kancelarja në detyrë si dhe u morën në konsideratë edhe shpjegimet e saj. U vlerësua se, për sa i përket dokumentacionit justifikues për të ardhurat e z. {...}, i cili jeton dhe punon në shtetin grek që në vitin 1995, nuk disponohen dokumente për të ardhurat e tij, përveç dokumentit që kancelarja në detyrë ka dorëzuar në ILDKPKI, i ardhur nga shteti grek, i cili i përket huadhënies prej 37,000 euro, të marrë nga bashkëshorti i saj, të cilat bashkëshorti më pas ja ka dhënë shtetasit {...} me kontratë huaje (akt noterial), shumë kjo ashtu si është deklaruar i janë kthyer në dorë nga shtetasi {...}.

17. Komisioni i Planifikimit Strategjik, Administrimit dhe Buxhetit, i mbledhur në datë 06.12.2021, duke konsideruar të plotë procedurën e verifikimit të kushteve dhe kriterëve ligjore dhe dokumentacionin e administruar në kuadër të saj, bazuar në pikën 25, Seksioni C, Kreu IV, të Vendimit 424/2020, vendosi kalimin e çështjes për shqyrtim në mbledhjen e Këshillit të Lartë Gjyqësor për të vlerësuar dhe vendosur ky i fundit për kualifikimin dhe lejimin e kancelares në detyrë, znj. {...}, për të marrë pjesë në provimin e vlerësimit profesional ose për skualifikimin dhe ndërprerjen e marrëdhënieve të saj të punës.

18. Këshilli në vijim të hetimit administrativ ndaj kancelares në detyrë, Znj. {...}, në mbledhjen e datës 10.10.2022 ka vendosur t'i drejtojë disa pyetje subjektit, lidhur me kontratën e huasë që ajo ka pretenduar se ka pasur me vëllain e saj, z. K. {...}, në shumën e 37.000 euro, që ka shërbyer si burim për dhënien e huasë në shumën e 40.000 Euro, nëse kjo e fundit ka qenë e formalizuar me ndonjë akt, nëse kjo hua/kontratë është deklaruar më parë nga subjekti, pra detyrimi që ajo ka pasur ndaj vëllait të saj, nëse është shlyer ky detyrim si dhe mënyra e shlyerjes së tij. Subjekti nëpërmjet shkresës të protokolluar në Këshill me nr. 5430 prot., datë 14.10.202, ka shpjeguar se: *“Në vitin 2009 bashkëshorti im E.{...} ka marrë një hua nga vëllai im K. {...} prej 37.000 Euro, pa interes dhe pa afat kthimi, të cilën më pas ja kemi dhënë hua shtetasit {...}. Kjo hua është marrë në kohën ku ajo dhe bashkëshorti i saj nuk ishin subject deklarimi të pasurisë, prandaj nuk i kemi kushtuar vëmendje ndaj mbajtjes së dokumentacionit të duhur, duke qenë se marrëdhëniet familjare ishin dhe janë të shkëlqyeshme. Dua të theksoj se vëllai im është “subjekt juridik” në shtetin grek, në Korfuz që në vitin 2000 dhe kishte mundësi për dhënien e huasë. Në vitin 2013 dhe pikërisht në datë 12.12.2013 kam filluar punë si kancelare në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Pukë dhe tani që është bërë subjekt i deklarimit të pasurisë dhe interesave private e kam deklaruar si hua në deklaratën para fillimit të detyrës dhe tek deklarimi periodik. Kjo hua marrë nga vëllai dhe më pas dhënë hua shtetasit {...} e deklaruar si hua, por e pa shoqëruar me dokumenta përkatëse si huamarrje, të cilën në atë kohë na është kërkuar si dokument. Ia kërkoja vëllait që të vërtetojë me dokument këtë hua dhe vëllai ju drejtua zyrës shtetërore përkatëse që funksionon në shtetin grek duke deklaruar dhënien e huasë bashkëshortit të motrës {...}{...} duke ju nënshtruar të gjitha detyrimeve që rrjedhin nga kjo hua zyrës përkatëse, e shoqëruar me një dokument të firmosur, vulosur dhe të nënshkruar nga kjo zyrë dhe vëllait, të cilën e kam dorëzuar në ILDKPKI, dhe një kopje të përkthyer me noter po jua vëmë në dispozicion. Dua të theksoj se për asnjë rast nuk kam tentuar të fsheh të ardhurat familjare, por gabimet njerëzore të paqëllimshme ndodhin në*

çdo kohë por asnjëherë me dashje. Për sa i përket kthimit të huasë kemi vazhduar t'i kthejmë pjesë, pjesë që nga viti 2016 meqenëse huaja ishte marrë nga vëllai, pa interes dhe pa afat kthimi, kështu është vepruar që në vitin 2020 dhe pikërisht në datën 20.08.2020 kemi mbyllur likuidimin e huasë, për të cilën kemi mbajtur një document, deklaram për mbyllje huaje, mes palëve të cilën e kemi nënshkruar rregullisht nga të dyja palët”.

19. Në mbështetje të këtyre shpjegimeve, subjekti depozitoi shkresën e thjeshtë datë 20 gusht 2022, me titull *“Deklarim për shlyerje detyrimi”*, me deklarues bashkëshortin e subjektit, Z. {...}{...} dhe vëllain e saj, K. {...}, me përmbajtje: *Unë deklaruesi {...} Suljemani, lindur në Iballë, të rrethit Pukë dhe banues në qytetin e Pukës, me dokument identifikimi....., me cilësinë e huamarrësit në shumën e 37.000 euro marrë hua në vitin 2009 nga vëllai i bashkëshortes {...}, Kastriot Lek {...}..... Këtë vlerë monetare 37.000 Euro dhënë pa interes dhe pa afat kthimi marrë hua në vitin 2009, e vërtetuar me dokument vetdeklarues nga zyra e posaçme shtetërore në Korfuz, Greqi, me firmën e më vulë të autoriteteve greke si dhe të firmosur nga huadhënësi {...}. Shlyerjen e detyrimit e kam filluar në vitin 2016 dhe kam vazhduar kështu deri në Gusht të 2020, ku kam mbyll së likuiduari. Gjithashtu, ka depozituar edhe një deklaratë të vëllait të saj dt. 03.10.2016, e lëshuar para nëpunësit të shërbimeve të qytetarëve të Bashkisë Korfuz, në të cilën deklaroi me përgjegjësi personale se *“Gjatë vitit 2000 i kam dhënë dhëndrit tim {...} Suljemani 50 000 lekë pa kthim. Në vitin 2006 i kam dhuruar 1 600 000 lekë për blerje makine dhe në vitin 2009 i kam dhënë (borxh) hua 37.000 euro pa ndonjë afat”* shkresë që ishte depozituar edhe më parë pranë ILDKPKI.*

20. Pas dhënies së këtyre shpjegimeve, si dhe referuar dy raporteve të ILDKPKI, në kuadër të hetimit administrative, Këshilli vendosi të administrojë të gjitha deklaratat periodike vjetore të subjektit të deklaramit, Znj. {...}, që nga momenti kur ajo është bërë subjekt i deklaramit të pasurisë dhe interesave private, në datë 12.12.2013 e në vijim.

21. Nga përmbajtja e deklaramës përpara fillimit të detyrës dhe atyre vjetore është konstatuar se nga subjekti Z.{...} është deklaruar rregullisht kontrata e huasë nr. 367 rep., nr.180 kol., datë 04.05.2009 me palë huadhënësi b/shorti i kancelares {...}{...} dhe huamarrësi shtetasi {...}j, me objekt huadhënien në vlerën 40 000 euro, me afat 5 vjet deri në 24.04.2014 me interes 1% në vit. Në deklarime janë parashtruar edhe shlyerjet e bëra në kuadër të kësaj kontrate në vitet përkatëse, konkretisht shlyerja e kryer nëpërmjet bankës në vitin 2014 në shumën e 26. 368 euro, si dhe shlyerja tjetër në vlerën e 13. 632 euro, e deklaruar në deklaramën vjetore të vitit 2015. Në përmbajtje të kontratës, rezulton se palët kanë rënë dakord se; *“ Pala huadhënëse ka një vlerë monetare prej 40 000 euro, ku i jep palës huamrrëse me një afat kohor 5 vjeçar deri në 25.04.2014. Burimi i të ardhurave të palës huadhënëse deklaroi se ka burimin nga zhvillimi i aktivitetit privat shoqëri ku është aksioner si dhe nga emigracioni.....”.*

22. Ndërsa kontrata e huasë së pretenduar të lidhur midis bashkëshortit të saj {...}{...} dhe vëllait të saj K.{...}, në vitin 2009, me anë të cilën është marrë hua shuma prej 37,000 që ka shërbyer si burim për dhënien më pas të huasë prej 40,000 euro shtetasit {...}, nuk rezulton të jetë deklaruar më parë. Gjithashtu, në asnjë nga këto deklarata nuk është deklaruar as shlyerja e këtij

detyrimi të lindur, pra kthimi i shumës së dhënë prej 37,000 eure. Kjo kontratë është deklaruar dhe më pas është paraqitur dokumentacion provues lidhur me burimet e ligjshme të krijimit të kësaj shume të huadhënësit, z. K. {...} vetëm pas plotësimit të deklaratës së vetting-ut dhe fillimit të hetimit administrativ nga ILDKPKI dhe Këshilli. Gjatë hetimit administrativ, subjekti ka deklaruar se kjo shumë e marrë hua nga bashkëshorti i saj {...}{...}, vëllait të saj K. {...}, ka filluar të shlyhet, pra të kthehet detyrimi, në vitin 2016 dhe shlyerja është bërë pjesë pjesë, deri në gusht të vitit 2020 (20.08.2020). Por rezultoi se subjekti nuk ka deklaruar shlyerjen e këtij detyrimi në deklaratat vjetore të vitit 2016, e në vijim, as ekzistencën e detyrimit dhe as shuma e shlyer në secilin vit deklarimi, konform detyrimit të saj për të deklaruar të gjitha asetet e krijuara, të drejtat dhe detyrimet pasurore të krijuara gjatë periudhës së deklarimit si dhe çdo marrëdhënie tjetër juridiko-civile. Në të tilla kushte, një rrethanë e tillë nuk është vlerësuar më pas nga ILDKPKI, në kuadër të vlerësimit të burimeve të ligjshme të subjektit për të shlyer këtë detyrim.

23. Pas administrimit të kopjeve të deklaratave vjetore të pasurisë dhe interesave private, si dhe shpjegimeve të dhëna prej saj në përgjigje të pyetjeve të drejtuara nga Këshilli, subjekti është thirrur në seancë për të sqaruar disa çështje të vlerësuara si të nevojshme, lidhur me Kontratën e huasë të pretenduar të lidhur midis bashkëshortit të saj dhe vëllait të saj, për marrjen e huasë në shumën e 37,000 Euro. Në seancën plenare të datës 06.04.2023, znj. {...} ndër të tjera ka deklaruar se *“ajo ka katër motra, dy vëllezër, si dhe prindërit që jetojnë prej 28 vitesh jashtë shtetit dhe se ajo si motra e madhe, ka qenë si një nënë e dytë për ta dhe çdo burim të ardhurash që ata punonin, kursimet i sillnin tek ajo, në shenjë ruajtje. Dhe aty është bërë një gabim në fakt, se ato lekë unë i kam thënë vëllait se donin të ndihmonin një mik dhe i thamë t’ia jepnim borxh Rustem Strugës, dhe po ti marrë nga të ardhurat e tua. Ai më tha ok, por me të drejtë kthimi. Këto para janë shlyer përpara se unë të filloj detyrën si kancelare, pra para vitit 2013. Ne Rustemi na i ka kthyer paratë para vitit 2013, një pjesë në dorë dhe një pjesë me bankë dhe unë ia lashë aty ku ia kisha marrë vëllait”*.

24. Në vijim të hetimit administrativ, në mbledhjen plenare të datë 06.04.2023, Këshilli, si u njoh me të gjitha të dhënat e administruara nga burimet e ligjshme dhe veprimet verifikuese të realizuara në procedurën e verifikimit të pasurisë së kancelares në detyrë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Pukë, znj. {...}, përfshirë edhe përgjigjet e pyetjeve në komunikimet me shkrim gjatë procedurës si dhe ato të dhëna prej saj në mbledhje plenare, bazuar në nenet 55, 56 dhe 83, të ligjit nr. 98/2016 *“Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë”* dhe vendimin nr. 424, datë 12.10.2020 *“Për procedurën e verifikimit të kushteve dhe kritereve ligjore të rekrutimit të kandidatit për kancelar, për këshilltar ose për ndihmës ligjor”* vendosi të vijojë me komunikimin e gjetjeve në procedurën e verifikimit të pasurisë, të cilat mund të pasjellin skualifikimin e saj, duke e ftuar atë për të paraqitur shpjegime lidhur me gjetjen e procedurës së verifikimit, si dhe të çdo dokumentacioni mbështetës të nevojshëm sipas vlerësimit të saj. Konkretisht, Këshilli vendosi t’i komunikojë faktet e konstatuara gjatë procedurës së verifikimit si dhe gjetjet lidhur me to, si më poshtë:

- 1.** Dukjen e deklarimit të pasaktë të aseteve/pasurisë në lidhje me burimin e ligjshëm të shumës prej 40 000 euro dhënë hua shtetasit {...}, nga të cilat me akte zyrtare me fuqi të plotë provuese (kontrata noteriale e huasë dhe deklarimi me përgjegjësi personale e

shtetasit {...} para autoriteteve greke), provohet se 37.000 euro prej tyre janë marrë hua nga shtetasi {...}, ndërsa nga shpjegimet kontradiktore të kancelares në detyrë, kjo marrëdhënie kualifikohet në një moment si “hua” dhe në një moment tjetër si “pasuri e familjarëve në ruajtje”. Së fundmi me sqarimet e dt. 03.04.2023 kancelarja ka ndryshuar tërësisht deklaratimet e saj lidhur me burimin e ligjshëm të shumës së dhënë hua shtetasit {...};

2. Mosdeklarimin e marrëdhënies juridike dhe natyrën e saj, me titullarët e së drejtës së pronësisë së shumës prej 37 000 euro, në deklaratën e interesave private para fillimit të detyrës;
3. Dukjen e deklarimeve të pasakta e të pavërteta në deklaratat e interesave private periodike vjetore të mënyrës dhe kohës së shlyerjes së huasë nga shtetasi {...}, nëse do të pranohej si i vërtetë deklarimi i bërë së fundmi nga kancelarja, se e gjithë huaja nga ky shtetas ishte kthyer para se ajo të fillonte punën si kancelare;
4. Mosdeklarimin në deklaratat e interesave private periodike vjetore të shlyerjes së huasë shtetasit {...} sikundër pretendohet nga viti 2016 deri në vitin 2020, në vlerën totale prej 37.000 euro, në kushtet kur referuar detyrimin ligjor duhet të deklarohen të gjitha llojet e shpenzimeve vjetore me vlerë mbi 300 000 lekë;
5. Dukjen e mungesës së burimit të ligjshëm të pasurisë për të shlyer pjesërisht nga viti 2016 deri në gusht 2020, huanë e marrë shtetasit {...}, krahasuar me frekuencën e pakësimit të gjendjes së llogarisë së {...}{...}t pranë Raiffeisen Bank (monedha euro), ku ishte derdhur vlera prej 26,368 euro, si dhe investimet e shpenzimet e tjera të kryera gjatë kësaj periudhe të deklaruara në deklaratat periodike vjetore .

25. Pasi ju komunikuan këto fakte dhe gjetje, kancelarja në detyrë, nëpërmjet përfaqësuesit të saj paraqiti pretendimet e saj, në formën e pretendimeve lidhur të gjithë hetimin administrativ, duke kërkuar konfirmimin e saj në detyrë. Në këto pretendime, kancelarja parashtrroi se; *“e vërteta e vetme është se nuk kemi të bëjmë me një hua, por me “ të ardhura të lëna në ruajtje”, të ardhura nga burime plotësisht të ligjshme të faktuara edhe me aktet e dorëzuara më parë dhe që janë pjesë dosjes. Në të vërtetë janë deklaruar si veprime në momenti të mëvoshëm, por ama ku ka qenë gabim njerëzor nga ana e ekonomistit të saj. Të gjitha deklaratimet janë bërë nga ekonomisti i saj i besuar dhe ne i besojmë qëllimit të tij pozitiv për të qenë sa më tepër transparent në çdo veprimtari me karakter ekonomik në kushtet që në momente të mëvonshme të mos vinin kontradikta apo të cilësoheshin si të paqena. ... E vetmja e vërtetë është se këtyre të ardhurave të lënë në ruajtje, i është dhënë hua Z. {...} në datë 04.05.2009 dhe kjo hua është kthyer përpara se kancelarja të bëhet subjekt i deklaratimit të pasurisë. Huaja ka qenë për arsye emergjente, me motivacion shëndetësor dhe për këtë arsye janë detyruar që të gjitha të ardhurat e grumbulluara nga vëllezërit e motrat të shkonin në drejtim të këtij shtetasi për një periudhë të shkurtër kohore. ... Kjo hua e dhënë, pavarësisht çka është shkruar në aktin noterial është kthyer para se Znj. {...} të fillonte punën si kancelare ku tani u bë subjekt i deklaratimit në ILDKPKI dhe nuk ka ndikuar në asnjë rrethanë në rritjen apo pakësimin e pasurive, apo të ardhurave dhe shpenzimeve të familjes. ... Dua të sqarojmë se për sa i përket kthimit të huasë të deklaruar të dhënë ndaj shtetasit {...} përpara noterit, këto të ardhura me pas i janë dhënë hua djalit të xhaxhait por pa akt noterial, sepse marrëdhënie jonë personale ka qenë përtej akteve dhe kemi besim të verbër të njëri- tjetri.*

Kjo hua është shlyer nëpërmjet bankës me dy këste, kësti i parë i shlyer në vitin 2014 dhe deklaruar e shlyer në vitin 2015 dhe tjetri në 2015, deklaruar në vitin 2016...”.

26. Në mbledhjen plenare të datës 15.11.2023, Këshilli mori në analizë të gjithë dokumentacionin e depozituar nga kancelarja në detyrë, duke e ballafaquar me të dhënat sipas të dy raporteve të ILDKPKI-së, si dhe duke marrë në konsideratë edhe shpjegimet e saj dhe të përfaqësuesit ligjor av. Baftjar Rusi, arriti në konkluzionin se për kancelaren në detyrë {...} janë grumbulluar të dhëna të mjaftueshme mbi të cilat mund të konkludohet për ekzistencën e shkaqeve të skualifikimit të saj, konkretisht;

27. Rezultoi se kancelarja në detyrë nuk ka bërë deklaram të saktë dhe në përputhje me ligjin të interesave të saj private si në deklaratat vjetore ashtu edhe atë vetting, të cilat gjatë hetimit administrativ u mundua dhe i paraqiti në versione të ndryshme deklarimet e saj, për të justifikuar burimet e ligjshme për pasurinë/ shumën prej 40,000 euro, dhënë hua shtetasit {...} në vitin 2009, si dhe më pas kthimin e këtij aseti në vitet që ajo ka qenë subjekt i deklarimit të pasurisë dhe interesave private.

28. Nga hetimi rezultoi se në deklaratën përpara fillimit të detyrës së kancelares {...}, të vitit 2013 si dhe në deklaratat vjetore të saj, konkretisht të vitit 2014 dhe 2015 është deklaruar kontrata e huasë me nr. 367 rep 180 kol dt. 04.05.2009 me palë huadhënës b/shorti i kancelares {...}{...} dhe huamarrës shtetasi {...}, me objekt huadhënien në vlerën 40 000 euro, me afat 5 vjet deri në 24.04.2014 me interes 1% në vit, ku palët kanë rënë dakord se “ *Pala huadhënëse ka një vlerë monetare prej 40 000 euro, ku i jep palës huamrrëse me një afat kohor 5 vjeçar deri në 25.04.2014. Burimi i të ardhurave të palës huadhënëse deklaroi se ka burimin nga zhvillimi i aktivitetit privat shoqëri ku është aksioner si dhe nga emigracioni.....*” si dhe shlyerjet e bërë për këtë detyrim në deklaratat e interesave private periodike vjetore, përkatësisht për vitet 2014 dhe 2015. Shlyerja e huasë së mësipërme është bërë në dy këste : 26,368 euro janë derdhur në llogari rrjedhëse në emër të b/shorit të kancelares në dt. 02.09.2014, nga shtetasi {...}{...}, shumë që këtij të fundit i ishte dhënë dorazi nga pala huamarrese, çka provohet nga lëvizjet në llogarinë si dhe një deklaratë noteriale e administruar nga ILDKPI. Ndërsa diferenca prej 13,632 euro i është dhënë dorazi shtetasit {...}{...}. Kjo mënyrë shlyerje është deklaruar më pas edhe nga të dy palët {...}{...} dhe {...}j në një deklaratë tjetër noteriale Nr. 1203 rep., nr.582/2 kol., datë 24.10.2016 e administruar gjithashtu nga ILDKPI.

29. E pyetur nga ILDKPI lidhur me burimin e ligjshëm të shumës së dhënë hua prej 40 000 euro, kancelarja në detyrë ka depozituar në ILDKPI sqarime me shkrim, duke shpjeguar se si burim i të ardhurave të dhëna hua shtetasit {...}, ka shërbyer shuma prej 37.000 euro të marra hua nga vëllai i saj (shtetasi {...}) ndërsa për vlerën e diferencës prej 3000 euro nuk ka dhënë shpjegime të tjera. Për të provuar burimin e ligjshëm të shumës së dhënë hua kancelarja në detyrë ka dorëzuar në ILDKPI dokumentacion të lëshuar nga autoritetet greke midis të tjerash edhe një deklaratë të vëllait të saj dt. 03.10.2016 të lëshuar para nëpunësit të shërbimeve të qytetarëve të Bashkisë Korfuz, në të cilën deklaroi me përgjegjësi personale se “*Gjatë vitit 2000 i kam dhënë dhëndrit*

tim {...} Suljemani 50 000 lekë pa kthim. Në vitin 2006 i kam dhuruar 1 600 000 lekë për blerje makine dhe në vitin 2009 i kam dhënë (borxh) hua 37.000 euro pa ndonjë afat”.

30. Bazuar në situatën e paqartë faktike e ligjore si më sipër, gjatë hetimit administrativ Këshilli i kërkoi sqarime kancelares në detyrë lidhur me marrëdhënien e huasë që ajo dhe bashkëshorti kishin pasur me vëllain e saj z. {...} për shumën 37 000 euro, që sipas shpjegimeve të mësipërme kishte shërbyer për dhënien e huasë prej 40 000 euro, nëse ajo ishte e formalizuar me ndonjë akt apo ishte deklaruar më parë prej saj pranë ILDKPI, kthimin ose jo të kësaj huaje shtetasit {...}, dhe nëse po, cila kishte qenë mënyra e saj dhe nëse ishte deklaruar ndonjëherë ky detyrim (hua) që ajo kishte ndaj vëllait dhe kur ai ishte deklaruar. Fillimisht, në përgjigjet e pyetjeve të mësipërme administruar në Këshill në dt. 14.10.2022, kancelarja në detyrë sqaron se në vitin 2009 kishte marrë 37 000 euro hua nga vëllai i saj {...}, pa interes e pa afat kthimi, shume të cilën më pas ia kishin dhënë hua shtetasit {...} dhe se kjo shumë i ishte narrë në kohën kur ajo nuk ishte subjekt deklarimi në ILDKPI dhe nuk i kishte kushtuar vëmendje mbajtjes së dokumentacionit, pasi marrëdhëniet familjare me të vëllanë ishin të shkëlqyera. Ndërsa lidhur me burimet e krijimit të kësaj shume nga vëllai i saj, ajo ka shpjeguar se ai ishte regjistruar si person juridik në shtetin grek që në vitin 2000 dhe kishte mundësi për dhënien e huasë. Në vitin 2013 kur ajo është bërë subjekt deklarimi, pasi në dt. 12.12.2013 kishte filluar punë si kancelarë në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Pukë, sqaron se e kishte deklaruar këtë hua në deklaratën para fillimit të detyrës dhe tek deklarimi periodik. Për sa i përket kthimit të huasë kancelarja në detyrë ka sqaruar se ata (ajo dhe bashkëshorti) kanë filluar shlyerjen e huasë që nga viti 2016, duke vazhduar shlyerjen pjesë-pjesë deri në vitin 2020 dhe pikërisht në dt.20.08.2020 kanë mbyllur likuidimin e huasë me të vëllanë, për të cilën kanë mbajtur edhe një dokument. Por nga ballafaqimi i shpjegimeve të dhëna nga kancelarja në detyrë me deklaratat e interesave private periodike vjetore të saj të administruara nga ILDKPI, rezultonte se shuma e marrë hua nga vëllai i saj, vlera prej 37000 euro, nuk ishte deklaruar prej saj në deklaratën para fillimit të detyrës, edhe pse kjo marrëdhënie juridike sipas shpjegimeve të saj dhe deklarimeve me përgjegjësi të vëllait, të përdorura prej saj para ILDKPI e në Këshill, ekzistonte në atë moment dhe po kështu nuk rezultonin të ishin deklaruar shlyerjet pjesore që ajo pretendonte se i kishte kryer deri në likuidimin e plotë të huasë në gusht 2020, vetëm 3/muaj para se për të të fillonte procesi i verifikimit të pasurisë e figurës, megjithëse ka pasur detyrimin për deklarimin e çdo shpenzimi të kryer në vlerën mbi 300,000 lekë në vit.

31. Në ndryshim me deklaratimet e saj të mëparshme të dhëna gjatë hetimit administrativ, lidhur me kontratën e huasë së lidhur mes bashkëshortit të saj dhe vëllain e saj në shumën e 37,000 euro, që kishte shërbyer si burim për dhënien e huasë shtetasit {...} në shumën prej 40,000 euro, kancelarja në detyrë në datë 03.04.2023, depozitoi sqarime të tjera, duke shpjeguar tashmë se kjo shumë nuk ishte hua e marrë nga vëllai i saj, por që vëllezërit e motrat e saj i kishin kursyer në vite nga puna në Greqi dhe i kishin lënë tek ajo në ruajtje. Këtë fakt sipas saj e provonte një derdhje që bashkëshorti i saj kishte bërë në llogari bankare në dt. 09.01.2009 në vlerën 2 000 000 lekë me përshkrim “të ardhura nga emigracioni”. Sipas saj ky fakt tregon qartë se këto para janë të familjarëve të saj nga puna në emigracion. Në vijim të sqarimeve ajo shpjegon se duke qenë se këto të ardhura i kishte në ruajtje, bashkëshorti ia dha shtetasit {...} me akt noterial. Pavarësisht se çfarë është shkruar në aktin noterial, ajo deklaroi se këto të ardhura ishin kthyer para se ajo të

fillonte punë si kancelare, pra para datës 12.12.2013 dhe se ky përbëntë një deklaram të gabuar dhe jo me keqdashje. Ajo e shpjegon situatën si një deklaram të gabuar dhe jo me keqdashje. Të njëjtin qëndrim kancelarja mbajti edhe gjatë pyetjes së saj personalisht nga Këshilli si dhe pas komunikimit të gjetjeve, duke mos dhënë asnjë shpjegim bindës lidhur me derdhjet për kthim huaje, të kredituar në llogarinë bankare të bashkëshortit të saj si dhe ato të deklaruara prej saj në deklaratat vjetore të vitit 2014 dhe 2015, shuma këto që përputhem me shumën e dhënë hua prej tyre në vlerën e 40,000 euro dhe as për provat e tjera të paraqitura gjatë këtij hetimi.

32. Nëse do të pranoni këtë version të deklaramit të kancelares në detyrë, gjithsesi ajo sërish do të ishte në kushtet e deklaramit të pasaktë të pasurisë dhe interesave të saj private, të cilat janë deklaruara më parë si në deklaratat vjetore ashtu edhe në deklaratën vetting, përderisa ajo ka deklaruar se i ka dhënë një hua shtetasit {...}, detyrim që është kthyer më pas nga ky shtetas gjatë vitit 2014 dhe 2015, kohë gjatë secilës ajo ka qenë subjekt i deklaramit të interesave private, dhe ka pasur detyrimin e deklaramite të saktë të të gjitha këtyre interesave si në lidhje me burimin e krijimit ashtu dhe për subjektet me të cilën ajo apo personat e lidhur me të kanë pasur marrëdhënie juridike-civile. Edhe sikur të pranohej si i vërtetë fakti se detyrimi nga shtetasi {...} dhe ndaj vëllait të saj është krijuar dhe më pas shuar/shlyer përpara fillimit të detyrës, datë 12.12.2013, kancelarja në detyrë ka pasur gjithashtu detyrimin për deklaramin e saktë të shumës së kredituar në llogarinë bankare të bashkëshortit të saj prej 26,368 euro në dt. 02.09.2014, nga shtetasi {...} {...}, për marrëdhënien që ka ekzistuar midis tyre si dhe burimin e krijimit të kësaj shume. Gjithashtu, e njëjti detyrim vlen edhe për shumën prej 13,632 euro, që është deklaruara prej saj në deklaratën vjetore të vitit 2015, por edhe gjatë hetimit administrativ, se i është kthyer nga shtetasi {...} si shlyerje e detyrimit të dhënë më parë hua prej bashkëshortit të saj {...} {...} në vitin 2009, shumë këto që kanë shërbyer më pas si burim për mbulimin e shpenzimeve dhe krijimin e pasurive të subjektit deklaruara, të cilat janë llogaritur dhe vlerësuar në ILDKPKI në vlerësimin tërësor të pasurisë së saj dhe të personave të lidhur. Por siç e theksuam lart, ky deklaram i kancelares në detyrë nuk përputhet me deklaramet e saj vjetore si dhe me provat e paraqitura, që kanë të bëjnë me ekzistencën e një kontrate noteriale të lidhur midis dy palëve kontraktuese, deklaramin e bërë përpara noterit publik të të dy kontraktuesve lidhur me shlyerjen e këtij detyrimi, të bashkëshortit të saj dhe të shtetasit {...}, si dhe të deklaramit me vetpërgjegjësi të vëllait të saj, K. {...} lidhur me ekzistencën e këtyre huave, si dhe shlyerjen e tyre, të deklaruara më parë nga vetë subjekti, për të cilat ajo nuk dha asnjë shpjegim bindës.

33. Ndërsa në rast se do të pranohej si i saktë deklarami i bërë nga kancelarja Znj. {...} gjatë procedurës së hetimit administrativ, lidhur me huanë e marrë vëllait të saj {...} në vitin 2009, në shumën prej 37,000, që ka shërbyer si burim krijimit të shumës prej 40,000 të dhënë hua shtetasit {...}, si dhe shlyerjen e kësaj huaje shtetasit {...} sikundër është pretenduar nga viti 2016 deri në vitin 2020, në vlerën totale prej 37.000 euro, sjell si pasojë mungesën e burimeve të ligjshme të pasurisë së subjektit për të shlyer huanë e marrë, krahasuar kjo me frekuencën e pakësimit të gjendjes së llogarisë së {...} {...} pranë Raiffeisen Bank (monedha euro), ku ishte derdhur vlera prej 26,368 euro, si dhe investimet e shpenzimet e tjera të kryera gjatë kësaj periudhe të deklaruara në deklaratat periodike vjetore. Konkretisht, rezultoi se nga llogaria bankar pranë Raiffeisen Bank

sh.a (monedha euro) me titullar {...}{...}, ku është kredituar shuma prej 26, 368 euro, me përshkrimin si shlyerje huaje, sipas raportit të ILDKPI-së janë tërhequr këto shuma :

- a. në vitin 2015 shuma prej 12 045 euro, e padeklaruar si pakësim në DPV përkatëse dhe as gjendje “cash” në 31.12.2015, çka krijon dukjen se shuma është përdorur tërësisht në vitin 2015. Nga ana tjetër këtë vit deklarohen 2 550 000 lek si shpenzime për rikonstrukcion shtëpie dhe 550 000 për arsimim;
- b. në vijim nga kjo llogari janë tërhequr në vitin 2016 shuma prej 5000 euro, e padeklaruar si pakësim në DPV përkatëse dhe as gjendje “cash” në 31.12.2016, çka krijon dukjen se shuma është përdorur tërësisht në vitin 2016. Kjo shumë nuk është deklaruar në DPV si shpenzim për shlyerje huaje tek {...};
- c. në vitin 2017 nga kjo llogari janë tërhequr 9000 euro e padeklaruar si pakësim në DPV përkatëse dhe as gjendje “cash” në 31.12.2016, çka krijon dukjen se shuma është përdorur tërësisht në vitin 2017. Kjo shumë nuk është deklaruar në DPV si shpenzim për shlyerje huaje tek {...};
- d. në vitin 2018 nga kjo llogari janë tërhequr 3502 euro e padeklaruar si pakësim në DPV përkatëse dhe as gjendje “cash” në 31.12.2018, çka krijon dukjen se shuma është përdorur tërësisht në vitin 2018. Kjo shumë nuk është deklaruar në DPV si shpenzim për shlyerje huaje tek {...}. Ndërkohë që po këtë vit deklarohet tërheqje nga e njëjta llogari e vlerës prej 8000 euro dhe dhënia 10,000 euro me kontratë huaje një vjeçare shtetasit {...}.
- e. Vlera e llogarisë pakësohet tërësisht në dt. 25.04.2019, e cila gjithashtu nuk deklarohet në DVP përkatëse dhe as përdorimi i vlerës së mbetur shtetasit {...}.
- f. DPV 2016 : Kthyer pjesa tjetër e huasë së mbetur dorazi prej 13.632 euro, por nuk deklarohet “cash” në 31.12.2015 e as në vitet e mëpasshme, çka krijon dukjen se shuma është përdorur tërësisht në vitin 2015. Kjo shumë nuk është deklaruar në DPV si shpenzim për shlyerje huaje tek {...}.

34. Në këto kushte, çmon se mos deklarimi i saktë të interesave pasurore dhe private të subjektit, si edhe deklaramet e saj kontradiktore mbi burimet financiare që kanë shërbyer për shumatat e dhënë hua shtetasit {...}, si dhe për shumatat e depozituara në llogarinë bankare të bashkëshortit të saj në vlerën prej 26,368 euro si dhe prej 13.632 euro, të deklaruar rregullisht në deklaratat vjetore të subjektit ashtu dhe gjatë hetimit administrativ, shuma këto që janë llogaritur dhe më pas janë vlerësuar në ILDKPKI si një ndër burimet e krijimit të pasurisë në pronësi të saj apo të përmbulimit e shpenzimeve, çojnë në pamundësi për të verifikuar se cilat nga deklaramet e subjektit pasqyrojnë situatën e vërtetë faktike lidhur me pasurinë dhe interesat private të subjektit.

35. Gjithashtu, të gjithë këto deklarime kontradiktore të kancelares në detyrë gjatë gjithë procedurës së verifikimit të pasurisë, shpjegimi i ndryshëm i bërë prej saj lidhur me burimin e ligjshëm të shumës prej 40 000 euro dhënë hua shtetasit {...}, dhe sidomos deklaramet e fundit sipas të cilat ky detyrim si dhe shuma e marrë hua prej vëllait të saj kanë lindur dhe janë shlyer përpara fillimit të detyrës së saj, i cili përmbys tërësisht të gjitha deklaramet e mëparshme të saj, si në deklaratat vjetore ashtu dhe në atë vetting, si dhe provat e paraqitura, zbehin tërësisht vërtetësinë e deklarameteve të saj mbi të gjitha asetet e burimet e ligjshme për krijimin e tyre, aq sa krijohet dukja se kancelarja në detyrë nuk ka një të vërtetë jetësore të vetme për të mbrojtur, por duke e

prezantuar atë në versione tërësisht të ndryshme nga njëri-tjetri, përpiqet të krijojë një gjendje fakti të volitshme për efekt të procedurës dhe jo të deklarojë saktë dhe qartë asetet/pasurinë si dhe burimin e ligjshëm të krijimit të tyre.

36. Një konkluzion i tillë mbështetet edhe nga analiza e deklarimeve vjetore të bërë nga kancelarja në detyrë Znj. {...}, të depozituara në ILDKPI, ku konstatohet se si ajo dhe personat e lidhur me të (bashkëshorti i saj), kanë treguar kujdes për deklarimin e kontratave të huasë së lidhur midis bashkëshortit të saj dhe shtetasve të tjerë, si dhe shlyerjet e bërë për këto kontrata/detyrime, kontratë që në rastin e z. {...} është lidhur përpara fillimit të detyrës së saj, situatë që nuk përputhet me shpjegimin e dhënë prej saj gjatë hetimit administrativ për gabimin apo harrimin në mosdeklarimin e kontratës së huasë së lidhur midis bashkëshortit të saj dhe të vëllait të saj apo shlyerjen e këtij detyrimi apo një gabim i bërë nga ekonomisti i saj. Nga këto rrethana, të krijohet bindja se deklarimi i bërë nga kancelarja në detyrë mbi ekzistencën e kontratës së huasë së lidhur midis bashkëshortit të saj dhe vëllait të saj, për marrjen e një huaje në shumën e 37.000 euro është bërë vetëm me qëllim për të justifikuar burimet e ligjshme për krijimin e shumës prej 40,000 euro të dhënë hua në vitin 2009 shtetasit {...}, pasi ka rezultuar se subjekti dhe bashkëshorti i saj nuk kanë pasur burime të ligjshme të mjaftueshme për të justifikuar krijimin e kësaj shume në vitin 2009, kthimi i të cilës është bërë gjatë kohës kur kancelarja në detyrë është bërë subjekt deklarimi, shuma të cilat më pas janë përdorur dhe vlerësuar prej ILDKPI për mbulimin e shpenzimeve familjare apo për krijimin e pasurive gjatë periudhës së deklarimit. Në arritjen e këtij përfundimi, nga Këshilli u mbajt parasysh qëndrimi tërësisht i ndryshëm i mbajtur nga kancelarja në detyrë në përfundim të hetimit administrativ, pasi nga Këshilli iu drejtuan disa pyetje lidhur me problematikat e hasura mbi mosdeklarimin e kësaj huaje, ku në këtë rast kancelarja deklaroi se huaja ishte marrë dhe kthyer përpara fillimit të detyrës. Qëndrim ky që nuk gjen mbështetje në asnjë nga aktet e paraqitura si prova gjatë hetimit administrativ si pranë ILDKPI ashtu dhe në Këshill.

37. Sa më sipër, Këshilli vlerëson se nga verifikimi i kriterit të pasurisë për kancelaren në detyrë {...} janë grumbulluar të dhëna të mjaftueshme mbi të cilat konkludohet për ekzistencën e shkaqeve të skualifikimit të saj. Konkretisht, rezulton se:

- a) kancelarja në detyrë dhe personat e lidhur kanë plotësuar dhe depozituar rregullisht formularin e deklaratës së pasurisë;
- b) kancelarja në detyrë dhe personat e lidhur kanë plotësuar dhe depozituar rregullisht, të nënshkruara, autorizimet e kërkuara për verifikimin e pasurisë;
- c) kancelarja në detyrë dhe personat e lidhur nuk kanë burime financiare për të justifikuar pasuritë e tyre;
- d) deklarimi nga kancelarja në detyrë dhe personat e lidhur, i pasurisë, aseteve ose interesave private, të detyrueshme për t'u deklaruar, nuk është i saktë referuar “Deklaratës së pasurisë dhe interesave private të kandidatit për pozicione të ndryshme në institucionet e sistemit të drejtësisë”, datë 24.03.2021, si dhe nuk u paraqit dokumentacion i plotë justifikues ligjor për burimin e krijimit të pasurisë. Deklarimet e pasakta të konstatuara nga kontrolli i kësaj deklarate, u thelluan edhe më tej gjatë hetimit administrativ, nëpërmjet deklarimeve të saj kontradiktore, që bien ndesh dhe me

provat e paraqitura prej saj dhe të hetuara gjatë kontrollit të pasurisë, rrethana këto që përbejnë shkak të mjaftueshëm për skualifikimin e kancelares në detyrë znj. {...}.

Ç. Për kriterin e figurës

38. Për kancelaren në detyrë {...} u verifikua kriteri i figurës, përcaktuar në pikën 1, të nenit 83, të ligjit nr. 98/2016.

39. Konkretisht, për verifikimin e kriterit të figurës për kancelaren në detyrë {...}, u kërkua raportim nga institucionet ligjzbatuese. Nga raportimet e shërbimeve shtetërore informative nuk u identifikua dhe verifikua ndonjë e dhënë për lidhje ose kontakte të papërshtatshme të kancelares në detyrë {...} me persona të përfshirë në krimin e organizuar apo për përfshirjen e saj në veprimtari që çënojnë sigurinë kombëtare apo aktivite të kundërligjshme.

40. Po ashtu, për verifikimin e kriterit të figurës, KLGJ me shkresën nr. 5594 prot., datë 30.10.2020, kërkoi vënien në dispozicion të formularëve të vetëdeklarimit për kancelarët në detyrë nga Ministria e Drejtësisë, si organi i emërtesës së kancelarëve, në kohën e hyrjes në fuqi të ligjit nr. 138/2015, *“Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”*. Mbi këtë kërkesë të Këshillit të Lartë Gjyqësor, Ministria e Drejtësisë ka përcjellë në Këshill, shkresën me nr. 6906 prot., datë 12.11.2020, sipas të cilës formularët e vetëdeklarimit të kancelarëve në detyrë janë pranë njësisë përgjegjëse, Departamentit të Administratës Publike.

41. Me shkresën nr. 5594/2, datë 19.11.2020, iu kërkua Departamentit të Administratës Publike vënia në dispozicion e formularëve të vetëdeklarimit për kancelarët në detyrë. Mbi këtë kërkesë të Këshillit të Lartë Gjyqësor, Departamenti i Administratës Publike ka përcjellë në Këshill, me shkresën nr. 6084/1 prot., datë 24.11.2020, të gjithë informacionin e kërkuar dhe të përpunuar në zbatim të kërkesave të ligjit nr. 138/2015, *“Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”*.

42. Në kuadër të zbatimit të ligjit nr. 138/2015, *“Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”*, nga ana e Strukturës së Posaçme për Regjistrimin, Administrimin dhe Përpunimin e Formularëve të Vetëdeklarimit, janë kryer verifikimet e thelluara të të dhënave të formularit të vetë deklarimit për gjendjen gjyqësore dhe gjendjen civile të kancelares në detyrë. Në vijim të përgjigjeve të shkresave të ardhura nga Prokuroria e Përgjithshme, nga Sektori i Gjendjes Gjyqësore, pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve si dhe nga Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile, pranë Ministrisë së Punëve të Brendshme¹¹, nga nëpunësi përgjegjës i Strukturës së Posaçme pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor, pasi kreu verifikimet e rastit, nuk u konstatuan mangësi në të dhënat e deklaruara nga kancelari në detyrë në formularin e vetë deklarimit sipas kërkesave të ligjit, duke konkluduar se znj. {...}: *“- ka*

¹¹ Shih shkresën nr. 5347/142 prot., datë 23.06.2021, të Strukturës së Posaçme për Regjistrimin, Administrimin dhe Përpunimin e Formularëve të Vetëdeklarimit.

dorëzuar formularin e vetdeklarimit më datë 25.04.2016; - formulari i vetdeklarimit është bërë publik, në faqen zyrtare të ëeb të KLGJ-së; - në formularin e vetdeklarimit, nuk ka të deklaruar të dhëna që përfshihen brenda sferës së ndalimeve të parashikuara nga ligji; - nuk ka deklaruar gjeneralitete të mëparshme; - Sektori i gjendjes civile, me vendimin nr. 19, datë 07.10.2008, personi ka ndryshuar mbiemrin nga “Sylejmani” në “{...}”; - nga përgjigjet e ardhura nga zyra e gjendjes gjyqësore, rezulton e padënuar nga gjykatat penale shqiptare; - deri më sot nuk kemi pasur indicie apo të dhëna kryesisht, për të kërkuar verifikim të thelluar nga Prokuroria e Përgjithshme”. Për pasojë, u vlerësua që nuk kishte vend për verifikim shtesë nga Prokuroria e Përgjithshme.

43. Me shkresën nr. 5833/7/2, datë 04.12.2020, iu kërkuar Prokurorisë së Përgjithshme dhënia e informacionit të nevojshëm, në lidhje me aspektet si më poshtë:

- nëse subjektet në proces verifikimi kanë marrë cilësinë e personit në hetim në një procedim penal;
- nëse ndaj subjekteve në proces verifikimi është zbatuar një masë sigurimi me karakter personal ose pasuror;

- nëse ka të dhëna për procedime penale të mosfilluara, të pushuara apo të pezulluara, në të cilat përmendet emri i subjektit në proces verifikimi.

Mbi këtë kërkesë të Këshillit të Lartë Gjyqësor, Prokuroria e Përgjithshme¹² ka përcjellë informacionin nga të **22** (njëzetë e dy) prokuroritë pranë gjykatave të rretheve gjyqësore me juridiksion të përgjithshëm. Referuar përmbajtjes së secilit nga 22 informacionet e përcjella, nuk rezultoi që kancelarja në detyrë {...} të ketë marrë cilësinë e personit nën hetim në një procedim penal, ndaj tij të jetë regjistruar kallëzim/referim/procedim penal, të jetë zbatuar ndonjë masë sigurimi me karakter personal apo pasuror dhe as ka pasur të dhëna për procedime penale të mosfilluara, pushuara apo pezulluara.

¹²Shkresa nr. 1762/1 Prot., datë 11.12.2020 i Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Përmet; shkresa nr. 1367/1 Prot., datë 14.12.2020 i Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Gjirokastër; shkresa nr. 3850/1 Prot., datë 14.12.2020 i Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Berat; shkresa nr. 420/1 Prot., datë 15.12.2020 i Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Durrës; shkresa nr. 1369/1 Prot., datë 16.12.2020 i Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Mat; shkresa nr. 3768 Prot., datë 15.12.2020 i Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Pukë; shkresa nr. 365/1 Prot., datë 16.02.2021 i Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Krujë; shkresa nr. 2955/1 Prot., datë 15.12.2020 i Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Tropojë; shkresa nr. 8284/1 Prot., datë 08.03.2021 i Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Kurbin; shkresa nr. 1239/1 Prot., datë 16.03.2021 i Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Pogradec; shkresa nr. 15418/1 Prot., datë 28.12.2020 i Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë; shkresa nr. 3768 Prot., datë 15.12.2020 i Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Pukë; shkresa nr. 11820/1 Prot., datë 05.01.2021 i Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Lezhë; shkresa nr. 8658/1 Prot., datë 17.12.2020 i Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Lushnjë; shkresa nr. 1631/1 Prot., datë 15.12.2020 i Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Kukës; shkresa nr. 12300 Prot., datë 18.12.2020 i Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Elbasan; shkresa nr. 9766/1 Prot., datë 17.12.2020 i Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Shkodër; shkresa nr. 12931/1 Prot., datë 18.12.2020 i Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Vlorë; shkresa nr. 9360/1 Prot., datë 16.12.2020 i Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Fier; shkresa nr. 6251 Prot., datë 20.12.2020 i Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Korçë; shkresa nr. 2407 Prot., datë 23.12.2020 i Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Dibër; shkresa nr. 1025 Prot., datë 31.12.2020 i Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Kavajë; shkresa nr. 2616/1 Prot., datë 15.12.2020 i Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Sarandë.

44. Gjithashtu, mbi kërkesë të Këshillit të Lartë Gjyqësor¹³, Prokuroria e Posaçme kundër Krimit të Organizuar dhe Korrupsionit, me shkresën nr. 5679/20 prot., datë 21.04.2021, ka konfirmuar se nuk rezultojnë të dhëna që znj. {...} të ketë marrë cilësinë e personit nën hetim në një procedim penal, ndaj saj të jetë regjistruar kallëzim/referim/procedim penal, ndaj saj të jetë zbatuar ndonjë masë me karakter personal ose pasuror, ose të ketë të dhëna për procedime penale të mos filluara, të pushuara dhe të pezulluara.

45. Mbi kërkesë të Këshillit të Lartë Gjyqësor¹⁴, Byroja Kombëtare e Hetimit, me shkresën nr.281 prot., datë 28.06.2021, ka informuar se nuk disponon asnjë informacion në lidhje me kancelaren në detyrë {...}.

Për sa më sipër, nga përmbajtja e akteve të mësipërme konfirmohet se kancelarja në detyrë znj. {...}, nuk rezulton të jetë marrë në cilësinë e personit nën hetim në një procedim penal, ndaj saj të jetë regjistruar kallëzim/referim/procedim penal apo të jetë zbatuar ndonjë masë me karakter personal ose pasuror. Sa më sipër konfirmohet se për kancelaren në detyrë {...} nuk ka elementë të cënimit të figurës.

46. Nga verifikimi i kriterit të figurës për kancelaren në detyrë {...} janë grumbulluar të dhëna të mjaftueshme mbi të cilat mund të konkludohet për ekzistencën e shkaqeve të kualifikimit ose skualifikimit të saj. Konkretisht, rezulton se:

- a) kancelarja në detyrë ka plotësuar dhe depozituar rregullisht formularin e vetë deklaramit sipas kërkesave të ligjit nr. 138/2015;
- b) kancelarja në detyrë ka plotësuar dhe depozituar rregullisht, të nënshkuara, autorizimin për Këshillin e Lartë Gjyqësor që, në zbatim të pikës 83, Seksioni C, Kreu VI të vendimit 424/2020, të kryejë verifikimin në organet kompetente sipas ligjit, për të dhënat që lidhen me figurën dhe integritetin e tij;
- c) për kancelaren në detyrë nuk ka të dhëna për lidhje ose kontakte të papërshtatshme me persona të përfshirë në krimin e organizuar;
- d) për kancelaren në detyrë nuk ka ndonjë të dhënë tjetër në lidhje me figurën dhe integritetin e tij, mbi të cilën të ngrihen dyshime për vazhdimin e marrëdhënies së tij të punës në shërbimin civil gjyqësor.

III. KONKLUZIONE

47. Referuar përcaktimeve të Vendimit 424/2020, nga shqyrtimi i dokumentacionit të administruar gjatë procedurës së verifikimit të kushteve dhe kriterëve ligjore të pozicionit, pasurisë dhe figurës për kancelaren në detyrë në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Shkodër, znj. {...}, Këshilli i Lartë Gjyqësor vlerëson se procedura e verifikimit e ndjekur në këtë

¹³ Shkresa 5679/19 prot., datë 13.04.2021 e Këshillit të Lartë Gjyqësor.

¹⁴Shkresa nr. 2805/prot., datë 14.06.2021 e Këshillit të Lartë Gjyqësor.

rast është e plotë, por se subjekti rezultoi të ketë bërë deklarime të pasakta dhe ka mungesë të burimeve të ligjshme për të justifikuar pasuritë e krijuara dhe shpenzimet e kryera në përputhje me ligjin e për pasojë znj. {...} nuk mund të kualifikohet. Për këtë arsye Këshilli vendos ndërprerjen e marrëdhënies së saj të punës në funksionin e kancelares në gjykatë. Është vetë ligjvënësi (neni 83, pika 4, e ligjit nr. 98/2016) që e lidh mosplotësimin e kushteve dhe kriterëve ligjore të pozicionit “për kancelarin në detyrë” me pasojën e ndërprerjes së marrëdhënies së tij të punës.

48. Bazuar në sa është parashtruar më lart mbi rezultatet e verifikimit të kushteve dhe kriterëve ligjore të pozicionit, pasurisë e figurës, Këshilli i Lartë Gjyqësor vlerëson se kancelarja në detyrë nuk i përmbush një nga këto kriterë dhe ekziston shkak për skualifikimin e saj, konkretisht, lidhur me pasurinë e saj. Nisur nga kjo, Këshilli çmon se është vendi për skualifikimin e kancelares në detyrë në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Shkodër, znj. {...} dhe ndërprerjen e marrëdhënies së saj të punës.

PËR KËTO ARSYE:

Mbështetur në nenin 83, të ligjit nr. 98/2016, “Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, në nenin 61, pika 1, 86 shkronja “ë” dhe 97 pika 1, shkronja “a” të ligjit nr. 115/2016, “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar, Vendimin e Këshillit të Lartë Gjyqësor nr. 424, datë 12.10.2020, “Për procedurën e verifikimit të kushteve dhe kriterëve ligjore e ligjore të rekrutimit të kandidatit për kancelar, për këshilltar ose për ndihmës ligjor”, Këshilli i Lartë Gjyqësor,

VENDOSI:

1. Skualifikimin dhe ndërprerjen e marrëdhënies së punës së kancelares në detyrë në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Shkodër, znj. {...}.
2. Efektet juridike të pikës 1 të këtij vendimi, fillojnë pas marrjes formë të prerë të tij.
3. Një kopje e vendimit të arsyetuar t’i njoftohet Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Shkodër dhe kancelares në detyrë pranë kësaj gjykate, znj. {...}, sipas kërkesave të nenit 98, të ligjit nr.115/2016, “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar.
4. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit, brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga e nesërmja e komunikimit të vendimit të arsyetuar.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor, pasi të redaktohet për sigurimin e anonimatit të subjekteve.

PËR KËSHILLIN E LARTË GJYQËSOR